



Prishtinë, 15.10.2018
Kodi i ZRRE-së: V_1058_2018

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Bazuar në:

- Dispozitat e Neneve 15 dhe 26 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë,
- Dispozitat e Nenit 16 të Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë,
- Dispozitat e Nenit 7 të Licencës së Operatorit të Sistemit të Transmetimit,
- Kërkesën e KQKO për amendamentimin e Kodit të Rrjetit – Dispozita të Përgjithshme të datës 03 gusht 2018,

në seancën e mbajtur me datë 15.10.2018, nxori këtë:

VENDIM

- I. **APROVOHET** amendamenti i dokumentit “Kodi i Rrjetit të Transmetimit – Dispozita të Përgjithshme” të KOSTT Sh.a., si në shtojcë të këtij vendimi.

Arsyetim

- Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 04.10.2017 ka pranuar kërkesën e KQKO për amendamentimin e dokumentit “Kodi i Rrjetit të Transmetimit – Dispozita të Përgjithshme” të harmonizuar me legjislacionin në fuqi. Në këtë kuadër janë shtuar disa pika si edhe është bërë përshtatja e termave sipas legjislacionit në fuqi, përmirësime gjuhësore dhe rregullime të tekstit.
- ZRRE ka dhënë komente gjatë periudhës amendamentuese si pjesëmarrëse aktive në KQKO, por edhe pas dërgimit të dokumentit për aprovim në ZRRE, të cilat janë përfshirë në dokument. Në ndërkohë është paraqitur nevoja për ndryshim më të zgjeruar të Kodit të Rrjetit – Kodi i Kyçjes, si kërkesë e Komunitetit të Energjisë për përfshirjen në dokument të dispozitave të kodeve të rrjetit të UE (Requirements for Grid Connection of Generators dhe Demand Connection Network Code), që ka pasur ndikim në përmbajtjen e kodeve tjera.
- Pas përfshirjes së të gjitha komenteve dhe finalizimit të dokumentit, KQKO me datë 03.08.2018 ka dërguar dokumentin “Kodi i Rrjetit të Transmetimit – Dispozita të



Përgjithshme” në ZRRE me kërkesën për aprovimin e amendamentimit të tij.

- Pas vlerësimit të kërkesës së KQKO për amendamentim, ZRRE ka aprovuar amendamentimin e dokumentit “Kodi i Rrjetit të Transmetimit – Dispozita të Përgjithshme”.
- Të gjitha dispozitat tjera të dokumentit “Kodi i Rrjetit të Transmetimit – Dispozita të Përgjithshme” do të mbesin në fuqi.
- Dokumenti “Kodi i Rrjetit të Transmetimit – Dispozita të Përgjithshme” ver. 2.4 shfuqizon dokumentin “Kodi i Rrjetit të Transmetimit – Dispozita të Përgjithshme” ver. 2.3.

II. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

III. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i Zyrës së Rregullatorit dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.


Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund t’i drejtohet Gjykatës Kompetente brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të Vendimit në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.


Shtojcë: Dokumenti “Kodi i Rrjetit të Transmetimit – Dispozita të Përgjithshme” i amendamentuar.

Vendimi i dërgohet:


- Të licencuarit KOSTT Sh.A.
- Arkivit të Zyrës së Rregullatorit për Energji

Bordi i ZRRE-së


Arsim Janova, u.d. kryesuesit


Besim Sejfiqaj, anëtar


Selman Hoti, anëtar


Izet Rushiti, anëtar